



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT - Njoftim për mediumet-

Shkup, 12.08.2022

Shkallë e ulët e zbatimit të masave të Qeverisë në sektorin e turizmit

Mungesa e të dhënave në kohë, të konsoliduara dhe të qarta për mbështetjen e dhënë financiare, e bën të pamundur përgatitjen e analizave në kohë dhe efikase të efektit të masave të qeverisë në sektorin e turizmit

Enti Shtetëror i Revizionit ka kryer revizionin e suksesit me temën “Efikasiteti i masave dhe politikave të marra për uljen e efekteve të pandemisë në sektorin e turizmit”, i përfshirë në Programin Vjetor të Punës së ESHR-së për vitin 2021.

Qëllimi i revizionit të kryer është t'i përgjigjet pyetjes **“Masat dhe politikat e ndërmarra nga Qeveria e RMV-së dhe institucionet kompetente, a janë në funksion të zhvillimit të turizmit dhe uljes së efekteve të krizës pandemike në sektorin e turizmit?”**

Revizorët arritën në përfundimin se krijimi i masave dhe politikave duhet të kryhet me planifikim strategjik afatmesëm dhe afatgjatë në nivel shtetëror, me përcaktimin e qëllimeve dhe prioriteteve, si dhe nevojën për analizë të ndikimit të masave me çka do të sigurohet monitorim i efikasitetit të zbatimit të tyre dhe do të jepen drejtime për veprim në të ardhmen.

Mosdisponueshmëria e të dhënave në kohë, të konsoliduara dhe të qarta për mbështetjen e dhënë financiare, e bën të pamundur përgatitjen e analizave në kohë dhe efikase të efektit të masave të qeverisë në sektorin e turizmit.

Revizorët konstatuan nivel të ulët të zbatimit të masave në sektorin e turizmit, edhe atë:

000 denarë

Masa të cilat shkaktojnë shpenzime të drejtpërdrejta buxhetore gjegjësisht implikime të drejtpërdrejta fiskale						
Paketi	Masa	Plani i mjeteve për masën [1]	Mjetet e përdorura [2]	Mjetet e papërdorura [3]	Përdoruesit [4]	Përqindja e implementimit [5]=[2]/[1]
I	Vauçer për turizmin e brendshëm	704.106	386.172	317.934	64.788	55%
II	Grant për udhërrëfyes turistik	9.800	5.070	4.730	78	52%
III	Grant për agjenci turistike	116.850	79.820	37.030	276	68%
IV	Kthimi i tatimit turistik për vitin 2019	120.000	57.924	62.176	214	48%
V	Mbështetja financiare për hotelet të cilat funksionojnë jashtë qendrave turistike, të cilat nuk kanë shfrytëzuar vauçerë	64.600	/	/	/	/
VI	Mbështetja financiare për agjencitë turistike	86.100	52.300	33.800	258	61%
VI	Mbështetja financiare për udhërrëfyesit turistikë	të dhëna të përmblëdhura	2429	/	79	/
VI	50.000 PCR teste falas	nuk ka të dhëna	/	/	/	/

Shkalla e ulët e realizimit të masave në fushën e turizmit **nuk korrespondon** me synimet e përcaktuara për përballimin e krizës pandemike.

Për sa i përket kornizës së vendosur ligjore që rregullon sektorin e turizmit, revizioni konstatoi se **ka nevojë për ndryshime** në rregulloret ligjore për shkak të vështirësive në zbatimin e zgjidhjeve ligjore, gjë që çon në vështërsi edhe realizimin e programeve për zhvillim të turizmit.

Me analizën e **Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2016-2021** dhe të **Planit të Veprimit 2019-2021**, revizorët konstatuan se nuk është ndjekur realizimi i aktiviteteve të planifikuara dhe është e pakënaqshme shkalla e zbatimit të aktiviteteve nga Plani i Veprimit, gjë që ndikon në planifikimin, krijimin, miratimin dhe zbatimin e politikave dhe masave në fushën e turizmit.

Në pjesën e realizimit të aktiviteteve programore të institucioneve kompetente për turizmin, është vërejtur **reduktim i vazhdueshëm** i Buxhetit për periudhën 2018-2021, me përjashtim të vitit 2020.

Gjithashtu është konstatuar nevoja **për përmirësimin** e kapaciteteve institucionale, **bashkëpunim dhe koordinim** të aktiviteteve në nivel qendror dhe lokal dhe **formimin e Komiteti për Turizmin** si autoriteti më i lartë përgjegjës për turizmin në vend.

Me ndërprerjen e punës së **Trupit Koordinues për Turizmin**, **nuk ka koordinim** të plotë ndërmjet institucioneve dhe bartësve të sektorit të turizmit, ndërsa veprimi individual sjell **uljen e ndikimit** të sektorit në krijimin e politikave intervente për përballjen me krizën Covid-19, llojin e masave, dhënien në kohë dhe realizimin e shpejtë të tyre.

Në lidhje me krijimin e masave ekonomike për përballimin e pandemisë, është konstatuar **mungesë dokumentacioni** për analizë dhe vlerësim të mëparshëm gjatë krijimit të masave, i cili bazohet në fushëveprimin e planifikuar dhe fondet e nevojshme për secilën masë ekonomike, kushtet dhe kriteret për dhënien e tyre, si dhe **analiza për ndikimin e masave** dhe përcaktimin e qëllimit që duhet të arrihet në afat të shkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Kjo situatë e bën të **vështirë monitorimin** e suksesit të zbatimit të masave, si dhe mungesën e udhëzimeve të ardhshme për veprim.

Qeveria e RMV-së **nuk ka sistem të vendosur** për ndjekjen e secilës masë në veçanti dhe **nuk është krijuar** dhe publikuar bazë qendrore e të dhënave e cila në nivel ditorë ose mujorë do të publikojë informacione për shkallën e realizimit të secilës masë në veçanti me të dhënat për mjetet e planifikuara, numrin e subjekteve afariste dhe qytetarët për të cilët janë dedikuar këto masa, burimin e mjeteve, shkallën e shfrytëzimit dhe mospërdorimit të tyre, si dhe arsyetimet për mos realizueshmërinë e masave.

Sa i përket kontrollit mbi realizimin e kushteve për mbështetjen financiare të dhënë agjensioneve turistike nga pakoja e gjashtë e masave, me revizionin u konstatua se nuk është e përcaktuar **mënyra e kontrollit** për realizimin e kushteve, si dhe nuk është përcaktuar **institucion kompetenet** për kryerjen e kontrollin dhe masat që do të merren në rast të mospërbushjes së kriterëve dhe të mosrimbursimit të mjeteve.

Me revizionin e kryer është marrë siguri e arsyeshme se Qeveria e RMV-së përmes masave të miratuara anti-kriz për të mbështetur sektorin e ekonomisë/turizmit, të cilat janë të fokusuara tek qytetarët, vendet e tyre të punës, siguria sociale, solidariteti dhe krijimi i ambientit për tejkalim më të lehtë të pasojave ekonomike nga virusi korona, si dhe aktivitetet programore të institucioneve kompetente për turizmin ndikuan pjesërisht në përballimin efektiv të pasojave të pandemisë dhe uljen e efekteve të krizës në sektorin e turizmit.

Kontaktet për shtyp:

Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72228 203

albiona.mustafa@dzt.gov.mk

Mijallçe Durgutov +389 70 358 486

mijalce.durgutov@dzt.gov.mk

Martin Duvnjak +389 75 268 517

martin.duvnjak@dzt.gov.mk